



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.5.2023

Nr: 510

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 427, NGA Z. IVI KASO PËR HAPJEN E ZYRAVE ZGJEDHORE NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË" AFËR QV-VE, BASHKIA LUSHNJË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 13 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

KËRKUES: Z. Ivi Kaso

OBJEKTI: Kërkohet marrja e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për hapjen e zyrave zgjedhore nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" afër QV-ve nr. 2856, 2856/1, 2856/2, 2866, 2866/1 dhe 2877 Lagjia "Kadri Qystri", shkolla "4 Dëshmorët", si dhe QV-së pranë kopshtit, Lagjia "Çlirimi", Lushnjë.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", e pika 2, si dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 13.5.2023 Nr: 510
Ora: 14:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 427, nga z. Ivi Kaso për hapjen e zyrave zgjedhore nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" afër QV-ve, Bashkia Lushnjë, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 maj 2023"

KONSTATOJ:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me denoncues Z. Ivi Kaso. Denoncimi është regjistruar me nr. 427 ID, datë 12.5.2023, të regjistrimit të denoncimeve. Nëpërmjet këtij denoncimi pretendohet se *“Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” ka hapur zyra zgjedhore në një distancë shumë afër, rreth 38 m, me vendndodhjen e QV-ve nr. 2856, 2856/1, 2856/2, 2866, 2866/1, 2877, Lagjia “Kadri Qystri”, shkolla “4 Dëshmorët”, si dhe 8 metra me QV-në pranë kopshtit, Lagjia “Çlirimi”, Lushnjë.”*

Pala kërkuese kërkon marrjen e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për këtë qëllim, lidhur me veprimet e kryera, sipas provave të paraqitura.

Nga analiza ligjore dhe pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi, vlerësojmë se zyrat zgjedhore janë vendosur në kundërshtim me nenin 5, pika 1 të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, *“Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”*,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, të Kodi Zgjedhor si dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, *“Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”*,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Lushnjë, për mbylljen e menjëhershme të zyrave zgjedhore afër QV-ve nr. 2856, 2856/1, 2856/2, 2866, 2866/1, 2877, Lagjia “Kadri Qystri”, shkolla “4 Dëshmorët”, si dhe QV-së pranë kopshtit, Lagjia “Çlirimi”, Lushnje.
2. Ngarkohen subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Lushnjë për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
3. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Lushnjë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI